



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 181/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha, dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Bosnjacka Jedinstvena Lista (BJL) me seli në Mitrovicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të emërimit të anëtarëve në KVV, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e subjektit politik Bosnjacka Jedinstvena Lista (BJL) me seli në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i me datën 05. 06.2014, ka pranuar një ankesë nga subjekti BJL me të cilën thekson se pas kërkesës që ka bërë në KQZ me datë 03.06.2014 me nr. të protokollit 1208-2014 duke kërkuar dokumentet nga KQZ-ja, siç janë: vendimi i KQZ-së për emërimin e shefit egzekutiv të komisionit komunal të zgjedhjeve në Mitrovicën Veriore, listën e anëtarëve të emërave të emëruar për KKZ në Mitrovicë Veriore, listën e të nominuarëve për kryesues në subjektet politike dhe OJQ-të si dhe kriteret në të cilat është bazuar KQZ-ja gjatë përcaktimit të numërimit për subjektet politike për 252 anëtarët.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore të BLJ-së për shkak të mos dhënies së përgjigjes në afatin ligjorë lidhur me emërimin e anëtarëve në KVV nga KQZ-ja, janë të palejuar që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f, meqenëse në asnjërin nga pika e lartëpërmenduar të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 181/2014 më datën 06.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*